REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

Nr. 697, datë 30.10.2019

PËR

## DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.319, DATË 15.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015-2020", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr.319, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

   "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015–2022".

2. Në dokumentin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

   a) Ndarja "Vlerësimi i ri i kostos për planin e ri të aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2018–2020", ndryshohet me përmbajtjen sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
   b) Lidhja 1/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me emërtimin "Plani i aktiviteteve dhe treguesit për periudhën 2018–2022", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
   c) Lidhja 2/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me emërtimin "Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë

Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike për planin e veprimit për periudhën 2018–2022", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kudo në vendim dhe në tekstin bashkëlidhur:

a) Fjalët "... Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2020 ..." zëvendësohen me "... Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 ...";
b) Fjalët "... Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020 ...", zëvendësohen me "... Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2022 ... ".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

## Vlerësimi i ri i kostos për planin e ri të aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2018-2022

Përcaktimi i kostos së realizimit për planin e ri të aktiviteteve për periudhën 2018-2022 u realizua nëpërmjet procesit të vlerësimit të kostos potenciale të nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe nën-aktiviteteve (produkteve) të parashikuara, nga secili institucion i cili ka përgjegjësinë kryesore në realizimin e këtyre aktiviteteve. Gjithashtu ky proces është bazuar dhe në vlerësimet aktuale të realizuara në kuadër të projekteve të ndryshme të cilat financojnë një sërë reformash në administratën publike shqiptare dhe kanë si institucione përfituese, institucionet e përfshira në zbatimin e këtij plani veprimi. Duhet të theksohet se kostimi i bërë në momentin e miratimit të strategjisë të SNRAP 2015-2020, për aktivitetet e periudhës 2018-2020 është përfshirë në kostimin e ri.

Fondet e vlerësuara të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të planit të ri të SNRAP për periudhën kohore 2018-2022, parashikohet të jenë në nivelin 1.97 miliardë lekë ose rreth 15.1 milionë euro (për qëllime llogaritje kursi i këmbimit EUR/ALL 1=130), të detajuara sipas lidhjes 2/1 "Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike për Planin e Veprimit për Periudhën 2018-2022". Në kostimin e strategjisë për disa aktivitete nuk është përfshirë kostoja administrative (pagesa e nëpunësve, të cilët kryejnë aktivitetet e tyre për shkak të detyrave të tyre funksionale), si dhe nuk janë kostuar 7 aktivitete, të cilat lidhen me procedurat e thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e insfrastrukturës TIK, për arsye se kjo varet nga proceset që paraprijnë këto aktivitete.

**Tabela 4: Kostoja e financimit sipas fushave për periudhën 2018-2022**

| Fusha | Vlera (000 lekë) |
|---|---|
| Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit | 211,280 |
| Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike | 1,293,800 |
| Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore | 92,691 |
| Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja | 374,387 |
| Totali | 1,972,158 |

**Grafiku nr. 4 Pesha specifike e kostos sipas fushave të SNRAP**




Siç vihet re, nga tabela 4 më sipër, peshën më të madhe në koston totale të këtij plani e zënë shpenzimet për zbatimin e aktiviteteve në fushën e organizimit dhe funksionimit të administratës publike, të cilat janë kryesisht investime në fushën e inovacionit, ku peshën kryesore e zënë investimet për sistemin IPSIS dhe objektivat që lidhen me përmirësime të shërbimeve ndaj publikut me qëllim rritjen e efiçencës, transparencës dhe komunikimit me publikun, të cilat, në një masë të madhe, përfshijnë një reformë të thellë në drejtim të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Shpenzimet për ICT zënë gati 63% të totalit të investimeve të nevojshme për zbatimin e reformës në administratën publike në vitet e ardhshme. Krahasuar me planet e mëparshme atë të 2015-2017 dhe 2018-2020, shpenzimet e trajnimet kanë pësuar një rritje në peshë specifike, duke arritur në

nivelin 16% në planin e ri. Kjo rritje e peshës specifike vjen dhe si rezultat i zbatimit të programit të shkëmbimit të eksperiencës së nëpunësve të rinj të administratës publike, program i financuar me fondet IPA në masën 2 milion Euro.

**Tabela 5: Zërat e shpenzimeve për periudhën 2018-2022**

| Zërat | Vlera (000 lekë) |
|---|---|
| Fond page | 104,981 |
| Shpenzime trajnimi | 323,972 |
| Ekspertizë | 275,869 |
| Investime ICT | 1,248,966 |
| Shpenzime të tjera | 18,370 |
| Totali | 1,972,158 |

**Grafiku nr. 5 Pesha specifike e kostos sipas zërave të SNRAP**




Sa i takon burimeve të financimit të planit të ri të veprimit, mbështetja nga financimet e huaja përllogaritet të jetë në masën 44%, ndërkohë që buxheti i shtetit mbulon 48% të kostove të këtij plani veprimi. Niveli i boshllëkut financiar përllogaritet të jetë vetëm 8%, siç ilustrohet në grafikun më poshtë.

**Tabela 6: Burimet e financimit 2018-2022**

| Fusha | Vlera (000 lekë) |
|---|---|
| Buxheti i shtetit | 944,391 |
| Financim i Huaj | 875,535 |
| Hendek financiar | 152,232 |
| Totali | 1,972,158 |

**Grafiku nr. 6 Pesha specifike sipas burimeve të financimit**




Në krahasim me Planin e Aktiviteteve 2018-2020, plani i ri i aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2018-2022 ka një kosto të shtuar prej 252`004 në mijë lekë, nga të cilat:

- → 38`458 në mijë lekë parashikohen të mbulohen nga buxheti i shtetit në Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 si kosto të punonjësve të institucioneve që janë të përfshirë në zbatimin e kësaj strategjie, punonjë stë cilët janë të angazhuar dhe kanë detyrë funksionale realizmin e aktiviteteve të parashikuara;
- → 128,528 në mijë lekë parashikohen të mbulohen nga financimi i huaj nga partnerët e zhvillimit;
- → dhe 85,018 në mijë lekë është shtesa në boshllëkun financiar, vlerë e cila mund të ulet më tej nëse një pjesë e aktiviteteve të planifikuara do të mbështeten nga OECD/SIGMA në fusha ku asistenca e kësaj të fundit ka qenë e rëndësishme për qeverinë, si: RIA, konsultimi publik etj.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11.1.2 | Programet model të transparencës për pushtetin vendor të hartuara | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM I 2019 | 3,736 | - | - | 3,736 |
| 11.1.3 | 61 koordinatorë të së drejtës për informim në pushtetin vendor të trajnuar | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM IV 2019 | 16,464 | - | - | 16,464 |
| 11.1.4 | Programet e transparencës të miratuara dhe të zbatuara në të gjitha bashkitë | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM IV 2022 | | - | - | |
| 11.2 | Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës | | | | | 15,638 | 1,670 | 210 | 13,758 |
| 11.2.1 | Regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve i vënë në funksionim të plotë | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | Në proces (nisur në 2017) | TM IV 2022 | 15,438 | 1,470 | 210 | 13,758 |
| 11.2.2 | Koordinatorët për të drejtën e informimit të trajnuar lidhur me përdorimin e regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM IV 2020 | TM IV 2022 | 200 | 200 | - | - |
| 11.3 | Rishikimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit me synim përmirësimin e: a) përmbajtjes dhe metodës së zbatimit të programeve të transparencës; b) mekanizmave të përgjegjësisë administrative; dhe c) rritjen e publikimit proaktiv të informacionit publik | | | | | 2,340 | - | - | 2,340 |
| 11.3.1 | Vlerësim të plotë ex-post të ligjit për të Drejtën e Informimit | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM II 2020 | 2,340 | - | - | 2,340 |
| 11.4 | Kapacitetet e burimeve njerëzore të KDIMDP për monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit të ngritura | | | | | 3,900 | 2,400 | - | 1,500 |
| 11.4.1 | Struktura e KDIMDP e rishikuar me synimin forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit (i) Struktura e miratuar; (ii) Nr. i punonjësve të shtuar | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM IV 2018 | kosto administrative | - | - | - |
| 11.4.2 | Kapacitete të forcuara përmes trajnimeve të zhvilluara në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale (i) Nr. i personave të trajnuar; (ii) Nr. i kurseve të trajnimit | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM IV 2022 | 3,900 | 2,400 | - | 1,500 |
| | | | | | | 1,972,158 | 944,391 | 875,535 | 152,232 |

NR.PROT. 5361/2
DATË 31.10. 2019

KRYEMINISTRISË
MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE